



DEC

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 5810 prot.

Vlorë, më 17.04 2024

PROJEKT -VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA
DJEGIA E BANESËS TË Z.RENATO SULLAJ DHE SHPËRBLIMIN FINANCIAR
NGA ANA E BASHKISË VLORË.**

Këshilli i Bashkisë Vlorë në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, neni 9/1 pika b, neni 29/1, neni 54 pika dh ,të ligjit nr.45/2019 datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”,në VKM Nr. 329 data 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” paragrafi III/ë dhe pika 3/a, pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Financës dhe Këshilli i Qarkut Vlorë,

VENDOSI:

1.Të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e Z.Renato Sullaj ,e ndodhur në lagjen “29 Nëntori”,Rajoni Nr3 Bashkia Vlorë, në datën 03.02.2024, sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë përkatësisht në masën:

A. 83.690 (tetëdhjet e tre mijë e gjashtëqind e nëntëdhjet) lekë për punime ndërtimi.
(167.380x50%)

B. 199.045(njëqind e nëntëdhjet e nëntë mijë e dyzet e pesë) lekë për mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake

- Shpërblimi financiar do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile të Bashkisë Vlorë.
- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile pranë Bashkisë Vlorë.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015, neni 55 pika .

KRYETAR

ERMAL DREDHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 5810 prot.

Vlorë, më 17 04 2024

RELACION

PËR

PROJEKT-VENDIMIN “MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA DJEGIA NË BANESËN E Z.RENATO SULLAJ DHE SHPËRBLIMI FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLORË “

Në zbatim të VKM Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.
Komisioni i Bashkisë Vlorë i ngritur me Urdhërin e Brendshëm Nr.301 datë 08.09.2023 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë ,shkoi në banesë për të konstatuar dëmet e shkaktuara nga djegia.

Renato Sullaj në datën 05.02.2024 ka paraqitur kërkesën me Nr1833 prot, për shkak të djegies së banesës e ndodhur në lagjen "29 Nëntori", Rajoni Nr.3, Bashkia Vlorë.
Mbas hartimit të proces-verbalit të konstatimit të gjendjes së banesës në datë 09.02.2024, është vijuar me shkresën përcjellëse me Nr.1833/1 prot, datë 01.03.2024 “Dërgohet dokumentacioni për banesën e djegur të z.Renato Sullaj” në Këshillin e Qarkut Vlorë për të vazhduar me preventivat e vlerësimit të dëmeve nga komisioni i ekspertëve.
Këshilli i Qarkut Vlorë me shkresën Nr.363/1, datë 21.03.2024 “Dërgim dokumentacioni për banesën e djegur të z.Renato Sullaj” ka dërguar preventivin e hartuar nga komisioni i ekspertëve, nga ku rezulton:

- Vlera e dëmeve në banesën e z.Renato Sullaj është 282.735 (dyqind e tetëdhjet e dy mijë e shtatëqind e tridhjet e pesë) lekë.

Aktualisht Bashkia Vlorë ka mundësi financiare për të ndihmuar familjet për banesat e djegura.

Për sa më lart i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesat e z.Renato Sullaj sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë dhe shpërblimin financiar i cili do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile të Bashkisë Vlorë.

DREJTOR

Adrian Vreshtazi

